



KOMUNA E RAHOVECIT

**RAPORT TREMUJOR
I PUNËS**

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE
PËRKUJDESJE SOCIALE**

JANAR - Mars 2024

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

PRVITI

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA



DITËNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Dokument përmes Shëndetësorëve Mirëqenies Sociale
Odhëtore za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje

TABELA E PËRMBAJTJES

VI. Nr. i prot.

59

Më

05.04.2024

RAHOVEC - ORAHOVAC

HYRJE.....2

AKTIVITETET.....2

PËRFUNDIMI.....4

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

DATË /A:	03.04.2024
REFERENC-Ë:	Raport tremujor i punës
PËR/ZA/TO:	z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës
CC:	z. Ali Morina – Shef i Kabinetit
NGA/OD/FROM:	z. Saranda Sallteku – Drejtoreshë e DShPS - së
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport tremujor i punës

HYRJE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë periudhës raportuese janar – mars, ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritisë së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushë veprimitaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2024, ky raport përfshin në mënyrë gjithëpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitet e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

AKTIVITETET

- DSHPS qysh në fillim të vitit 2024 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të pëershruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit-shëndetësni dhe mirëqenie sociale;
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DShPS-së;
- Është bërë shqyrimi dhe përgjigja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave 170 janë të miratuara
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme;

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

- Është duke vazhduar funksionimi i shërbimit mjekësor "Kujdesi Shtëpiak", i cili do ta lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata më sëmundje të rënda, të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime mjekësore nga ora 07:00 deri në orën 21:00;
- Në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, po ashtu dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat: Krushë e Madhe, Sapniq dhe Dobidol;
- Janë mbajtur ligjërata vetëdijesuese në QKMF në Rahovec me tema si: Pandemia COVID – 19, Vaksinimi AntiCovid, Trajtimi i prostatës me avull, Astma, etj.;
- Në kuadër të marrëveshjes me AQH-në, po trajnohen mjekët dhe infermierët pranë QKMF-së në Rahovec, po ashtu AQH-ja asiston në implementimin e mjekësisë familjare;
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e Komunës së Rahovcit;
- Në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec, funksionimi i aparatit e mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësitet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovcit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëgenies së saj;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrjet-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale:

- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i Komunës;
- Vazhdon renovimi i objekteve të QMF-ve.

Mirëgenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëgenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushë veprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimesh në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimesh në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

RAPORT TREMUJÓR I PUNÉS

1. RAPORTI I SHËRBIMEVE SOCIALE TË QPS-së RAHOVEC JANAR 2024 – MARS 2024

1.1. Pasqyra e rasteve të paraqitura në formë tabelore sipas kategorive:

RAPORT TREMUJÓR I PUNËS

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

44	<u>Dhunë familjare ndaj të miturës</u>										
45	<u>Dhunë fiziike ndaj të miturit</u>										
46	<u>Lëndim i lehtë trupor</u>		1								1
47	<u>Konflikt familjar</u>	1									1
48	<u>E mitur e zhdukur</u>										
49	<u>Person i zhdukur</u>										
50	<u>Person i dëbuar nga shtëpia</u>										
51	<u>Tentim vetëvrasje</u>	7		2							9
52	<u>Tentim vrasje</u>										
53	<u>Vrasje e rëndë</u>										
54	<u>Raport informues nga policia</u>										
55	<u>Mbikëqyrja/pezullim nga mbajtja e dënimit</u>										
56	<u>Shtetase e huaj që kërkon shërbim social</u>										
57	<u>Varrimi i foshnjës së gjetur</u>										
58	<u>Konstatim i gjendjes faktike</u>	3	3	2							8
59	<u>Vlerësim social për lirim nga nënshtetësia</u>	16	4	8							28
60	<u>Vërtetim për zotësinë e veprimit (armëmbajtje)</u>	29	23	31							83
61	<u>Vërtetim për zotësinë e veprimit (punësim)</u>	6	3	2							11
	<u>Kërkësë familjeve në nevojë</u>	2									
Gjithsej sipas muajve:		84	62	104							

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Raport i shërbimeve në QKMF, periudha janar-mars 2024:

Gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej 35,842 shërbime, prej tyre:

- 4023 raste urgjente të trajtuar në sektorin e urgjencës;
- 18569 terapi intramuskulare;
- 4977 infuzione;
- 1345 shërbime në laborator;
- 939 shërbime në Rtg cabinet;
- 143 mamografi;
- 1439 shërbime gjinekologjike;
- 820 vizita shtëpiake;
- 400 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç;
- 7 lindje.

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Ky raport tremujor paraqet theksin kryesor të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe në DShPS.

Me respekt,



PËRFUNDIM